



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. 492/5 prot.

Tiranë, më 27.12.2023

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Besnik Maho
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 12.12.2023, është njoftuar vendimi nr. 714, datë 15.11.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për z. Besnik Maho, ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pogradec.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

## **I. Rrethanat e çështjes**

**1.** Referuar nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë [...] *Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët ... të cilët kanë punuar në këto pozicione për të paktën 3 vjet [...].* Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, z. Besnik Maho, ka kërkuar t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit, si ish-gjyqtar për të tria kriteret e rivlerësimit, duke plotësuar formularin e vetëvlerësimit profesional, dorëzuar pranë ish-KLD-së, edhe atë të kontrollit të figurës, dorëzuar pranë ish-DSIK-së. Në kërkesën drejtuar ish-KLD-së dhe ish-DSIK-së, z. Besnik Maho ka kërkuar edhe rivlerësimin e pasurisë.

2. Me kërkesën e datës 31.1.2017, z. Besnik Maho ka kërkuar t'i nënshtrohet procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar, pasi më parë ka ushtruar detyrën si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Elbasan dhe, më pas, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Pogradec, gjatë viteve 2005, 2006 dhe 2007. Kërkesa është firmosur nga përfaqësuesja me prokurë të posaçme, znj. \*\*\*. \*\*\*. Po nga përfaqësuesja e posaçme, \*\*\*. \*\*\*, është dorëzuar pranë ish-DSIK-së deklarata për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, dorëzuar bashkë me kërkesën e datës 31.1.2017, edhe formulari i vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, dorëzuar pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë<sup>2</sup>, datë 8.11.2016.
3. Në datën 13.1.2021, përmes postës elektronike, Komisioni njoftoi z. Besnik Maho për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni gjithashtu i kërkoi z. Besnik Maho informacion shtesë sipas pyetësorit standard. Në përgjigje, z. Besnik Maho, në datën 28.1.2021, përmes postës elektronike, ka njoftuar Komisionin se tërheq kërkesën e tij për t'iu nënshtrohet procesit të rivlerësimit për arsyen se, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.1.2021, është shpallur fitues në konkurrimin për inspektor pranë ILD-së nga radhët e subjekteve jomagjistratë.
4. Në datën 30.4.2021, Komisioni<sup>1</sup> i ka kërkuar z. Maho: (i) konfirmim nga ILD-ja për emërimin si inspektor në këtë institucion nga radhët e subjekteve jomagjistratë; (ii) kërkesë me shkrim për tërheqjen e kërkesës për t'iu nënshtrohet procesit kalimtar të rivlerësimit; (iii) paraqitjen e formularit të deklarimit të pasurisë dhe dokumentacionit justifikues, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se Komisioni deri në momentin e shortimit nuk kishte administruar Raportin e vlerësimit të pasurisë nga ILDKPKI-ja, sipas nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
5. Në datën 6.5.2021, z. Besnik Maho ka përcjellë pranë Komisionit vlerësimin që ka kryer Inspektori i Lartë i Drejtësisë në lidhje me kandidaturën e tij si Inspektor nga radhët e subjekteve jomagjistratë, si dhe vendimin e shpalljes së kandidatëve fitues. Në lidhje me kërkesën e depozituar më parë për t'u tërhequr nga procesi i rivlerësimit, ka parashtruar se, në qoftë se i gjithë dokumentacioni që kishte depozituar është i plotë dhe i mjaftueshëm, për t'u vlerësuar si ish-magjistrat, pranë Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe Pogradec.
6. Më tej, z. Maho, më datë 14.5.2021, ndër të tjera, ka informuar Komisionin se: [...] *Në vijimësi të email-it tuaj të datës 30.4.2021, ju kam kthyer një përgjigje me email-in e datës 6.5.2016, ku në të njëjtën kohë kam qartësuar pozitën dhe interesin tim profesional që, nëse është e mundur, të vazhdoj procesin e rivlerësimit, duke qenë i dëshiruar të di fillimisht nëse i gjithë dokumentacioni që unë kam depozituar është i plotë dhe i mjaftueshëm për t'u vlerësuar si ish-magjistrat pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Elbasan dhe Pogradec [...].*
7. Në vijim të komunikimeve elektronike, Komisioni, me email-in e datës 14.5.2021, i është përgjigjur si vijon: [...] *Referuar email-it tuaj, Komisioni ka filluar procesin tuaj të rivlerësimit, për të cilin jeni njoftuar me anë të postës elektronike. Deri më tani, Komisioni ka të konfirmuar*

---

<sup>1</sup> Email, datë 30.4.2021: [...] *Më tej, kërkojmë një konfirmim nga ILD-ja për emërimin tuaj si Inspektor pranë ILD-së nga radhët e subjekteve jomagjistratë dhe një kërkesë me shkrim për tërheqjen tuaj nga procesi i rivlerësimit kalimtar [...].*

*se ju nuk keni dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë sipas parashikimeve të nenit 31, "Fillimi i procedurës së vlerësimit të pasurisë", pika 3 e ligjit nr. 84/2016<sup>2</sup>[...].*

**8.** Në vijim, me *email*-in e datës 18.5.2021, z. Besnik Maho është shprehur se deklarata e pasurisë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, është nisur në drejtim të ILDKPKI-së nga bashkëshortja e tij, \*\*\* \*\*\*. Në lidhje me personin e tij, informacioni që lidhet me aspekte pasurore nuk u pranua të dorëzohej në zyrën e protokollit të ILDKPKI-së, për arsye se nuk ishte në atë kohë pjesë e sistemit të organeve të drejtësisë. Dorëzimin e materialeve të vlerësimit profesional e ka kryer personalisht gjatë muajit nëntor 2016, ndërsa dorëzimin e deklaratës së vlerësimit të figurës në ish-DSIK e ka dorëzuar në emrin e tij znj. \*\*\* \*\*\*. <sup>4</sup>

**9.** Me *email*-in e datës 21.5.2021, Komisioni i ka bërë me dije z. Besnik Maho se: (i) me shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë 20.1.2021, ILDKPKI-ja, informon se z. Besnik Maho nuk ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe se [...] *duke qenë se jemi përpara një prove shkresore nga institucioni kompetent, i takon atij të provojë të kundërtën e kësaj shkrese me anë të një prove tjetër shkresore, që të vërtetojë dorëzimin e kërkesës bashkë me shtojcën 2 tek organi kompetent sipas parashikimeve të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016 [...].* (ii) e fillon hetimin për procesin e rivlerësimit vetëm pas administrimit të një raporti të hollësishëm dhe të arsyetuar me konstatimet përkatëse nga institucionet e vlerësimit, në rastin konkret, ILDKPKI-ja.

**10.** Me *email*-in e datës 25.5.2021, z. Besnik Maho ka përcjellë shkresën nr. \*\*\*/\*\* prot., datë 19.5.2021, të drejtorit të Filialit të Posta sh.a., Tiranë, me anë të së cilës informon se dokumenti, me bar kod nr. \*\*\*, është depozituar në degën postare Tiranë, në datën \*.1.2017, dhe është dorëzuar në destinacion në datën \*.2.2017.

**11.** Në vijim, me vendimin e datës 17.10.2023, Komisioni, ndër të tjera, ka vendosur: (i) të përfundojë hetimin sipas kërkesës së z. Besnik Maho mbi plotësimin e kriterëve për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit si ish-gjyqtar sipas relacionit të paraqitur nga relatorja e çështjes,<sup>5</sup> duke arritur në përfundimin se: [...] *z. Besnik Maho nuk është subjekt rivlerësimit, pasi nuk plotëson kriterin e parashikuar nga pika 4, e nenit 179/b, të Kushtetutës, të ketë punuar të paktën 3 vjet në pozicionin e gjyqtarit. Në këtë kuptim, duket se Komisioni është në kushtet e ndërprerjes së procesit të rivlerësimit për zotin Besnik Maho, pa një vendim*

---

<sup>2</sup> [...] Subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë e Kushtetutës, ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit për vlerësimin e pasurisë brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Kërkesa i bashkëlidhet deklaratës së pasurisë sipas shtojcës 2 të këtij ligji. Me sa ne konstatojmë, ju nuk keni paraqitur kërkesë pranë Komisionit apo ILDKPKI-së dhe nuk keni bashkëlidhur deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2 të ligjit, për këtë arsye, ne ju kërkojmë me *email* që të provoni deklaratimet tuaja [...].

<sup>3</sup> Bashkëshortja, znj. \*\*\* \*\*, për shkak të statusit të saj si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë iu nënshtrua procesit të rivlerësimit. Pas paraqitjes së dorëheqjes nga ana e saj, me vendimin nr. 715/2023, Komisioni vendosi të ndërpresë procesin e rivlerësimit për znj. \*\*\* \*\*, duke zbatuar për të ndalimin me afat 15-vjeçar për t'u emëruar në pozicionet përkatëse, si pasojë e zbatimit të nenit G të aneksit të Kushtetutës.

<sup>4</sup> Subjekti ka bashkëlidhur përgjigjes së tij: (i) Prokurë e posaçme e datës \*.10.2016, lëshuar në \*\*\*, SHBA; (ii) Procesverbal i datës \*.11.2016, mbajtur në zyrën e Protokoll-Arkivit, pranë KLD-së, mbi marrjen në dorëzim të deklaratës të vetëvlerësimit të aspekteve profesionale; deklaratë e pasurisë së subjekteve magjistratë, si dhe të atyre që kanë qenë magjistratë dhe kërkojnë të rivlerësohen, datë \*.1.2017; (iii) të dhëna elektronike të aplikimit të kryer pranë Zyrës Qendrore të Postës Shqiptare, datë \*.1.2017.

<sup>5</sup> Po ashtu (ii) të njoftojë kërkuesin mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë kërkuesin për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë kërkuesin mbi të drejtat që gëzojnë nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

*përfundimtar për çështjen [...]. Sa më sipër i ka kërkuar z. Maho të japë shpjegime dhe/ose paraqesë prova lidhur me rezultatin e hetimit deri në këtë fazë të procesit.*

**12.** Me *email*-in e datës 24.10.2023, z. Besnik Maho paraqiti pretendimet me shkrim mbi rezultatet e hetimit, duke parashtruar, ndër të tjera, se: [...] *Në lidhje me procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, interesin tim të ligjshëm për të aplikuar dhe për të qenë pjesë e këtij procesi (të cilin vijoj ta kem edhe sot) e kam shfaqur jo vetëm në kërkesën dhe dokumentacionin e dorëzuar në KLD, DSIK dhe ILDKPI, por edhe në një sërë komunikimesh zyrtare të zhvilluar me KPK. Si subjekt i rivlerësimit, nuk mu dha asnjë përgjigje zyrtare gjatë 2 viteve e pesë muaj nga KPK, nga data që depozitova provat e lartpërmendura, por më vihet në dispozicion Relacioni i Hetimit, pa zhvilluar hetim nëpërmjet gjithë procedurës të rregullt që kërkon ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe Kushtetuta e Republikës të Shqipërisë. Konstatimi i Komisionit se unë, si kandidat i rivlerësimit... nuk e plotësoj afatin e ushtrimit të detyrës për të paktën tre vjet, është një konstatim që nuk qëndron... Si përfundim, nga data 17.9.2004, që kam ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e rrethit Gjyqësor, Elbasan, ku kam dhënë më shumë se 200 vendime gjyqësore personalisht dhe si anëtar i trupave gjyqësore në këtë gjykatë gjatë një viti dhe deri në datën 21.5.2008, janë më shumë se tri vite periudhe vjetërsi gjyqtar për efekt të nenit 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë [...].*

**13.** Komisioni, me *email*-in e datës 27.10.2023, i kërkoj z. Besnik Maho konfirmimin për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore për të shprehur qëndrimin e tij. Pas disa komunikimeve nëpërmjet *email*-it, nisur nga fakti se z. Maho nuk është përgjigjur në mënyrë të qartë lidhur me pyetjen e Komisionit nëse dëshiron të paraqitet në seancë dëgjimore për të dhënë shpjegimet e tij, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, me *email*-in e datës 9.11.2023, ka ftuar z. Besnik Maho për t’u dëgjuar lidhur me rezultatet e hetimit, në seancë dëgjimore më datë 13.11.2023, ora 13:00.

**14.** Në datën 13.11.2023 u zhvillua seanca dëgjimore, në mungesë të kërkuarit, z. Besnik Maho dhe me praninë e vëzhguesit ndërkombëtar. Komisioni, bazuar në provat që disponon lidhur me periudhën e ushtrimit të detyrës si gjyqtar<sup>6</sup>, vendosi përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar pa një vendim përfundimtar për z. Besnik Maho, për shkak se nuk ka punuar për një periudhë 3-vjeçare në detyrën e gjyqtarit, sipas parashikimit të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës.

**15.** Komisioni, bazuar në pikën 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 16, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenin 95 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, me shumicë votash, ka vendosur (ndër të tjera, si pjesë e dispozitivit): [...] *Të deklarojë përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar për kërkuarin, Besnik Maho [...].*

## **II. Vlerësimi i Komisionerit Publik**

**16.** Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri

<sup>6</sup> Referuar rrethanat dhe faktet, në mënyrë të shtjelluar në vendimin e Komisionit.

Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

**17.** Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisioneri Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit (në vijim referuar si Kolegji).

**18.** Në krahasim me kompetencat e njohura Komisionit dhe Kolegjit, nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit, në momentin procedural të njoftimit të vendimit të Komisionit, sipas nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

**19.** Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet përfundimtare të dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij, në të cilën janë arsyetuar në mënyrë të plotë konkluzionet dhe qëndrimi i Komisionit për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues dhe vlerësim të drejtë të provave.

**20.** Sa më sipër, Komisioneri Publik, nga shqyrtimi i vendimit përfundimtar nr. 714, datë 15.11.2023, çmon se përmban shkaqe ligjore për t'u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit. Komisioneri Publik, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ushtron të drejtën e ankimit ndaj vendimit përfundimtar nr. 714/2023, të Komisionit, *për deklarimin e përfundimit të procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar, për z. Maho.*

### **III. Shkaqet e ankimit**

#### **III.A Analiza e shkaqeve të ankimit**

**21.** Nga vendimi nr. 714/2023, rezulton se z. Besnik Maho ka shprehur kërkesën/vullnetin e tij për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, nga radhët e ish-gjyqtarëve, me arsyetimin se, në vitet 2004–2007 ka punuar si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Elbasan dhe Pogradec. Po ashtu, rezulton se kërkuesi ka plotësuar formularin e vetëvlerësimit profesional, duke e dorëzuar pranë ish-KLD-së dhe atë të kontrollit të figurës, dorëzuar pranë DSIK-së. Ndërkohë që kërkesa drejtuar ish-KLD-së dhe DSIK-së ka të përfshirë edhe kërkesën për rivlerësimin e pasurisë.

**22.** Komisioni, në kuadër të verifikimit të kritereve ligjore të parashikuara nga neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës, bazuar në provat e administruara, ndër të tjera, ka arsyetuar se: [...] *duke marrë në konsideratë faktet se: (i) z. Besnik Maho nuk e ka emrin në listat e përcjella nga organi kompetent, ish-KLD; (ii) Komisioni i Përkohshëm për Vlerësimin Etik dhe Profesional të KLGJ-së konfirmon se z. Maho nuk e ka statusin e magjistratit – vlerëson se në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, në vitin 2016, kërkuesi, Besnik Maho, nuk e ka*

*statusin e magjistratit, për shkak se, pas shkarkimit të tij nga detyra e Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së, nuk ka paraqitur kërkesë pranë KLD-së për t'u rikthyer në vendin e mëparshëm të punës si gjyqtar, duke e humbur për shkak të ligjit (ex lege) statusin e magjistratit. Komisioni vlerëson se llogaritja e afatit të ushtrimit të detyrës të z. Besnik Maho fillon nga data 3.10.2005, kur është emëruar/caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Pogradec, pas përfundimit të periudhës së stazhit profesional. Në analizë të datave të sipërcituara, z. Besnik Maho, me Dekretin nr. \*\*\*, datë 3.10.2005, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Pogradec dhe ka ushtruar funksionin e gjyqtarit deri në datën 19.6.2007 dhe, duke llogaritur këtë periudhën kohore, rezulton se z. Maho ka punuar në pozicionin e gjyqtarit për një periudhë 1 vit, 8 muaj dhe 16 ditë [...].*

**23.** Komisioneri Publik, në analizë të akteve në dosje, rezultateve të hetimit, prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit, ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni dhe konstaton se z. Besnik Maho, për sa i takon kriterit të vjetërsisë në pozicionin e gjyqtarit, e plotëson kushtin për t'u konsideruar subjekt rivlerësimi nga radhët e ish-gjyqtarëve.

**24.** Për këtë element, vjetërsinë në pozicionin e gjyqtarit, për të arritur në konkluzionin nëse z. Besnik Maho duhej t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik merr në analizë pikën 16, të nenit 3 të ligjit nr.84/2016, e cila referon në nenin 179/b të Kushtetutës. Pika 16, e nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, ka parashikuar se: [...] “*Subjekt i rivlerësimit janë të gjithë personat e parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës*”, dhe neni 179/b i Kushtetutës, në pikat 3 dhe 4, ka parashikuar se: “3. Të gjithë gjyqtarët [...] i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*. 4. [...] *Procesit të rivlerësimit mund t'i nënshtrohen me kërkesë dhe nëse plotësojnë kriteret sipas ligjit edhe ish-gjyqtarët [...] të cilët kanë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet* [...]”.

24.1 Pika 3 e nenit 179/b të Kushtetutës iu referohet të gjithë gjyqtarëve, të cilët e mbajnë statusin e magjistratit/gjyqtarit në momentin e hyrjes në fuqi të ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, ndërsa fjalia e dytë e paragrafit 4 iu referohet *ish-gjyqtarëve që nuk e kanë këtë status, por kanë punuar të paktën tre vjet në këto pozicione, dhe nëpërmjet kërkesës, pasi të kalojnë procesin e rivlerësimit, mund të rikthehen në sistem*.

24.2 Referuar, nenit 31, pika 3, nenit 35, pika 3, si dhe nenit 41, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, sipas nenit 179/b, pika 4, fjalia e dytë, të Kushtetutës: [...] *ka të drejtë të paraqesë një kërkesë me shkrim drejtuar Komisionit, për vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duke i bashkëlidhur kërkesën deklaratave të plotësuara, sipas shtojcës përkatëse të këtij ligji* [...].

24.3 Sa më lart, lidhur me kushtet e nevojshme për t'u plotësuar në rastin e z. Besnik Maho, për t'iu nënshtuar procesit të rivlerësimit, mbeten për t'u vlerësuar dy situata faktike: (1) *afati 3-vjeçar i punës në pozicionin e gjyqtarit*, si dhe (2) *vullneti/kërkesa e shprehur brenda afatit ligjor për nënshttrimin ndaj këtij procesi dhe plotësimi i deklaratave respektive*.

24.4 Referuar vendimmarrjes së Komisionit, në kushtet kur ky i fundit (Komisioni) e ka bazuar atë (vendimmarrjen) vetëm në konstatime që lidhen me provueshmërinë e kriterit të vjetërsisë në pozicionin e gjyqtarit, për më shumë se 3 vjet, Komisioneri Publik nënvizon si vijon.

**25.** Referuar akteve në dosje të Komisionit, lidhur me ecurinë dhe karrierën profesionale të z. Besnik Maho në sistemin e drejtësisë, rezulton se:

(i) Me diplomën nr. \*\*/\*\*, nr. regjistri \*\*, është diplomuar në Shkollën e Magjistraturës për periudhën *tetor 2002 – tetor 2005*, me titullin “*Magjistrat Gjyqtar*”;

(ii) Me Dekretin “*Për emërim Gjyqtari*”, nr. \*\*\*, datë *17.9.2004*, të Presidentit të Republikës, është emëruar gjyqtar dhe është caktuar të kryejë stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Elbasan;

(iii) Me Dekretin “*Për caktim gjyqtari*”, nr. \*\*\*, datë *3.10.2005*, të Presidentit të Republikës, është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Pogradec.

25.1 Në datën *13.6.2007*, në mbështetje të nenit 27/1, të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, nenit 4/3, 4, 5, 6 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, ka paraqitur pranë ish-KLD-së: [...] *kërkesën për t’u dorëhequr nga funksioni i gjyqtarit dhe miratimin e kërkesës për t’u angazhuar në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë* [...].

25.2 Për sa i përket gjyqtarëve/prokurorëve, që shërbenin në strukturat juridike të Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se neni 4, i ligjit nr. 8678/2001, që përcakton *statusin e funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë*, respektivisht në pikën 5 dhe 6 të tij, parashikon se: [...] **5. Periudha e ushtrimit të funksionit politik a të shërbimit civil në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, njihet si periudhë vjetërsie në punë si gjyqtar a prokuror për efekt të kërkesave të karrierës profesionale, të parashikuara në dispozitat ligjore për organizimin e pushtetit gjyqësor, Gjykatën e Lartë, Gjykatën Kushtetuese dhe prokurorinë. 6. Gjyqtarët a prokurorët që shërbejnë në strukturat e përmendura në pikën 3 të këtij neni, me kërkesë të tyre, riemërohen gjyqtarë a prokurorë pa konkurs [...].**

25.3 Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2007, i ka kërkuar ish-KLD-së dhënien e pëlqimit dhe miratimin e kërkesës për dorëheqje të z. Besnik Maho dhe për kalimin e tij me detyrë pranë Ministrisë së Drejtësisë: [...] *duke qenë se angazhimi i tij në nivelet drejtuese të strukturave juridike të Ministrisë së Drejtësisë nuk e zhvesh gjyqtarin Besnik Maho nga statusi, bazuar në paragrafin e parë dhe të katërt të nenit 4, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001* [...].

25.4 KLD-ja, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.6.2007: [...] *pasi shqyrtoi kërkesën për dorëheqje të z. Besnik Maho nga detyra e gjyqtarit, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, për shkak se do të angazhohet në strukturat juridiko-profesionale të Ministrisë së Drejtësisë* [...], ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje dhe lirimin e tij nga ajo detyrë.

25.5 Me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.2007, z. Maho është emëruar Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, detyrë të cilën e ka mbajtur deri më datë 21.5.2008, kur me VKM nr. 627/2008, është shkarkuar nga detyra dhe nuk ka vijuar ushtrimin e detyrës në asnjë prej institucioneve të drejtësisë apo strukturave të Ministrisë së Drejtësisë.

25.6 Ndërkohë, në momentin e ndërprerjes së punësimit pranë strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, kishte hyrë në fuqi ligji nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i cili shfuqizoi ligjin nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë. Ky ligj, në të njëjtën frymë me ligjin paraardhës, në nenin 28, “*Ruajtja e statusit të gjyqtarëve që shërbejnë në institucione të*

tjera”, në pikën 1 dhe 3 të tij, parashikonte se: [...] *I. Gjyqtarët, me kërkesën e institucioneve e pëlqimin e tyre, si dhe me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, mund të shërbejnë për një afat deri në 3 vjet në strukturat e Ministrisë së Drejtësisë, të administratës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndihmësligjor ose këshilltar i gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës së Apelit, prokuror, pedagog ose drejtor në Shkollën e Magjistraturës. Në përfundim të këtij afati, gjyqtarët kthehen në vendin e mëparshëm të punës...3. Periudha e shërbimit njihet si periudhë vjetërsie në profesion si gjyqtar, për efekt të pagës dhe të karrierës profesionale [...].*

25.7 Nga informacioni i administruar nga KLGJ-ja, rezulton se, vetëm në datën 13.9.2013, 5 vite pas ndërprerjes së ushtrimit të detyrës pranë strukturave të Ministrisë së Drejtësisë, z. Besnik Maho ka paraqitur kërkesë në KLD për t’u rikthyer në detyrën e gjyqtarit, duke pasqyruar ndërmjet të tjerave si shkak se, në zbatim të nenit 4 të ligjit nr. 8678/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i lindte e drejta të kërkojë rikthimin në sistemin gjyqësor. Referuar raportit nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2013, të KLD-së, “*Mbi rezultatet e kandidatëve për 13 vende vakante ...*”, rezulton se z. Besnik Maho figuron i renditur në listën e kandidatëve “jo gjyqtarë magjistratë”, por pa pasur vendimmarrje për kërkesën e paraqitur.

25.8 Nga aktet në dosje, lidhur me karrierën e tij profesionale, rezulton se z. Besnik Maho, me vendimin nr. \*\*\*, datë 25.1.2021, të ILD-së, është shpallur fitues në konkurrimin për inspektor pranë ILD-së nga radhët e subjekteve jomagjistratë.

25.8.1 Komisioneri Publik, referuar këtyre fakteve dhe rrethanave juridike, lidhur me përcaktimin e vjetërsisë në detyrën e gjyqtarit për z. Besnik Maho, në vlerësim të dispozitave ligjore në fuqi, për efekt të procesit të rivlerësimit, konstaton se përlllogaritja e kësaj vjetërsie, në rastin konkret, duhet të fillojë nga data 17.9.2004 e të shtrihet deri më datë 21.5.2008 (duke e përmbushur kriterin kohor prej 3 vitesh), kur ai është shkarkuar nga detyra dhe nuk ka qenë më në shërbim, si pjesë e institucioneve në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

25.9 Komisioneri Publik vlerëson se arsyetimi i Komisionit se llogaritja e afatit të ushtrimit të detyrës nga personi në fjalë fillon nga data 3.10.2005, kur me Dekretin nr. \*\*\* është caktuar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Pogradec, pas përfundimit të periudhës së stazhit profesional, nuk mbështetet nga rrethanat faktike, dokumentacioni i administruar dhe as në legjislacionin e zbatueshëm.

25.10 Komisioneri Publik, pa i hyrë interpretimeve literale mbi këtë arsyetim të Komisionit, por në një vlerësim faktik të asaj çfarë përcakton neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës, mbi kërkesën që ish-gjyqtarët duhet të kenë punuar në këto pozicione të paktën tre vjet, konstaton po ashtu se rezulton e provuar se z. Besnik Maho, nga data 17.9.2004 deri më 3.10.2005, është emëruar dhe ka punuar në pozicionin e gjyqtarit për stazhin e kryer, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Elbasan, duke gëzuar në këtë mënyrë të drejta dhe marrë përsipër detyrime si magjistrat<sup>7</sup>. Këto të drejta dhe detyrime janë gëzuar dhe janë përmbushur prej tij, sipas legjislacionit në fuqi, nga data 17.9.2004 dhe në vijim, për sa më sipër trajtuar.

<sup>7</sup> Neni 21 i ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikonte se, gjatë periudhës së stazhit profesional, i emëruari gëzonte të drejta dhe kishte detyrime njësoj si magjistratët.

25.11 (2) Lidhur me verifikimin e vullnetit/kërkesës së shprehur nga z. Besnik Maho, për nënshkrimin ndaj procesit të rivlerësimit, si dhe plotësimit të deklaratave respektive, Komisioneri Publik konstaton se ky element, me gjithë specifikat e evidentuara të rastit konkret, ndonëse pasqyrohet në parashtrimin e rrethanave në vendimin përkatës, nuk është marrë në analizë dhe nuk ka qenë shkak i vendimmarrjes përfundimtare nga ana e Komisionit dhe, në këto kushte, nuk gjen trajtim as në këtë ankim të Komisionerit Publik.

26. Në përfundim, në analizë të rrethanave të faktit dhe kuadrit ligjor të zbatueshëm, Komisioneri Publik vlerëson se përfundimi i arritur nga shumica e trupit gjykues, duke deklaruar përfundimin e procesit të rivlerësimit pa një vendim përfundimtar, nuk gjen mbështetje në faktet dhe parashikimet ligjore të cituara më sipër.

#### **IV. Kërkimi i ankimit**

27. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin;

28. Nisur nga fakti se Kolegji i shqyrton çështjet dhe vendos standardet bazuar në parimet e procesit të rregullt ligjor, parimin e kontradiktoritetit, parimin e ligjshmërisë, parimin e sigurisë juridike dhe parimin e barazisë para ligjit, si dhe korrigjon çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit, duke mbajtur parasysht të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar;

29. Referuar nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F, të aneksit të Kushtetutës, jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese, kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66/1, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

1. Prishjen e vendimit nr. 714, datë 15.11.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
2. Urdhërimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit të vijojë të kryejë procedurat administrative në kuadër të procesit të rivlerësimit për kërkuesin, z. Besnik Maho, ish-gjyqtar.

**KOMISIONERI PUBLIK**

**Florian BALLHYSA**